

TË NDËHHOSH TË TJERËT
MUK TË KUSHTON AGJË THJESHT
TË NDËHHON TË NDËHESH
MË KIRËMË E EDUKUAR.

PUNOI: FABIOLA SHAHINI
SHKOLLA: FABIL GURMANI



SHËRBIME ME BAZË KOMUNITARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Save the Children



Projekti “Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara” zbatohet nga Save the Children në partneritet me Shoqatën “Ndhmoni Jetën” dhe bashkëpunim me Bashkitë Durrës, Vlorë (2017-2021) dhe Kukës (2019-2021) nëpërmjet qendrave komunitare, të cilat ofrojnë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Projekti mundëson ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat përfshijnë mundësi për rehabilitim dhe ri-integrim, ndërhyrje në fazë të hershme, trajtim individual si dhe mbështetje e integruar për familjet e tyre. Ofrimi i shërbimeve me bazë komunitare realizohet nga një ekip multidisiplinar i profesionistëve dhe synon përmirësimin e aksesit, cilësisë së shërbimeve dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, shkolla dhe komunitet.

Qendrat ofrojnë:

I. Shërbime direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara:

- 1) Vlerësim dhe ngritje e programeve edukative individuale për fëmijët që ndjekin programet e kopshteve dhe shkollave.
- 2) Terapi individuale dhe në grup për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet programeve si më poshtë:
 - Program psiko-edukativ në fushën e konjicionit
 - Program në fushën e komunikimit
 - Program i motorrikës fine dhe globale
 - Program pas shkolle për aftësimin parashkollor dhe shkollor
 - Program i modifikimit të sjelljes
 - Program i autonomisë personale
 - Program i art terapisë dhe lojës
 - Programi i terapisë fizike/fizioterapi
- 3) Mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara në banesën ku jetojnë, ku përfshihen shërbime terapeutike, edukative, informuese, fizioterapi, mbështetje psikologjike për fëmijët dhe prindërit.
- 4) Lehtësimi i procesit të regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla, mbështetja dhe monitorimi i gjithëpërfshirjes së tyre.
- 5) Ndërhyrje e hershme dhe shërbim në familjen e fëmijës me aftësi të kufizuara me metodën PORTAGE.

- 6) Mbështetja e të rinjve me aftësi të kufizuara për të përfituar nga trajnimet profesionale dhe ofrimi i mundësisë së intershipit në biznese të ndryshme me qëllim punësimin e tyre.
- 7) Art terapi nëpërmjet metodës HEART (program i hartuar për Shërim dhe Edukim nëpërmjet Artit).
- 8) Programe të këshillimit dhe menaxhimit të rastit për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 9) Aktivitete argëtuese me fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat promovojnë gjithëpërfshirjen sociale dhe pavarësinë e tyre.
- 10) Ngritja dhe mbështetja e grupeve të vetë-ndihmës të përbërë nga të rinjtë me aftësi të kufizuara, motrat/vëllezërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe shokët/shoqet e tyre.

II. Aftësimin e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të punuar me fëmijën dhe për të advokuar për përfshirjen e fëmijëve të tyre në arsim dhe komunitet.

- 1) Trajnim teorik dhe praktik i prindërve dhe kujdestarëve për të punuar me fëmijët e tyre në kushte shtëpie në fushat si: autonomi personale, trajtimi i problemeve të sjelljes, komunikim verbal.
- 2) Mbështetje dhe këshillim për anëtarët e familjes së fëmijës me aftësi të kufizuara për të forcuar dinamikën e familjes dhe për të krijuar një mjedis mbështetës për fëmijën dhe gjithë familjen.
- 3) Trajtime me prindërit dhe kujdestarët mbi çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- 4) Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e materialeve informuese (broshura, manuale, guida) për të mbështetur prindërit në aktivitetin e tyre të përditshëm me fëmijët me aftësi të kufizuara.

III. Rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike në nivel lokal për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin shkollor dhe në komunitet.

- 1) Trajnim dhe Koordinim me stafin e kopshteve dhe shkollave për zbatimin e Planeve Edukative Individuale të fëmijëve.
- 2) Orientim dhe mbështetje e stafit pedagogjik në kopshte dhe shkolla gjatë punës në zbatim të programeve arsimore me fëmijët me aftësi të kufizuara.

- 3) Bashkëpunim me Zyrat Vendore Arsimore në mbështetje të programit komunitar për fëmijët që ndjekin sistemin parashkollor dhe atë shkollor.
- 4) Ngritja dhe mbështetja e Rrjetit lokal të aktorëve (në fushën e shëndetit, arsimit, shërbimeve sociale, të drejtave dhe organizata të shoqërisë civile) që punojnë me/për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe forcimi i kapaciteteve të tyre bashkëpunuese për të mbështetur nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.
- 5) Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve në institucionet e edukimit të hershëm, në përmirësimin e cilësisë së mbështetjes, zhvillimit dhe edukimit të gjithë fëmijëve, përfshirë fëmijët me vështirësi në zhvillim, përgjatë fazave të zhvillimit të hershëm të tyre.

V. Ndërgjegjësimin e komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- 1) Bashkëpunimin me shkollat dhe komunitetin për realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese që promovojnë gjithëpërfshirjen dhe jetesën e pavarur për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 2) Informim dhe ndërgjegjësim i komunitetit nëpërmjet shpërndarjes së fletëve informative.



Qendra e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara, DURRËS

Lagjia Nr. 17. Rruga "Dalip Peza" Banesat Sociale (me qera) Durrës.
Tel: 052201845



Shoqata "NdiHmoni Jetën"

Fshati Prush, Njesia Administrative Vaqarr
Tirana-Albania

T: +355(044)803370

M: +355(0)682082190

E: info@helphthelife.org.al

W: www.helphthelife.org


Facebook: Help the Life Association



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7,
ish Pallatet 1 Maji (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë, Albania
Tel: +355 4 2261840 / 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania@savethechildren.net>

 Savethechildrenal

 SaveChildrenAlb